VENDIM
Nr. 176, datë 3.8.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; "*Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, nenit 15, të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "*Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit"* për muajin korrik 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me anë të shkresës nr. 15209 prot., datë 1.8.2018 (protokolluar në ERE me nr. 451/1 datë 1.8.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2018.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 mbi rishikimin e "*Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit",* pikërisht neni 8 i rishikuar", M*etodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Në përfundim, bazuar në informacionin e paraqitur në këtë aplikim, OSHEE sh.a. kërkon një çmim prej 12.86 lekë/kwh për furnizimin me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2018.

- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. bazohen në:

- çmimin maksimal të blerjes së energjisë elektrike për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE) dhe është e barabartë me çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike për vitin 2018 prej 8.5652 lekë/kwh, plus riskun 3% mbi çmimin e blerjes dhe si përfundim çmimi maksimal rezulton 8.82 lekë/ kwh;

- kosto administrative gjithsej (CA) rezulton 1.79 lekë/kwh;

- tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 210, datë 28.12.2017 *"Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018"* është 0.75 lekë/kwh;

- tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 211, datë 28.12.2017 "*Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018"* është 1.5 lekë/kwh;

- vihet re se OSHEE sh.a. edhe për muajin korrik 2018, vazhdon të mos paraqesë informacion mbi koston e disbalancave që shkaktohen nga klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe nuk ka deklaruar që i ka faturuar klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për këto kosto, ashtu siç kemi vërejtur dhe për periudhën janar–qershor 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12.86 lekë/kwh për muajin korrik 2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti